



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DIAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Për: Zyren Kombëtare të Auditimit
Kuvendin Komunal Gjakovë

Nga: z. Ardian Gjini, Kryetar i komunës së Gjakovës

Raporti i II-t ëPeriodik për Zbatimin e
Rekomandimeve
të dhëna në Raportin e Auditimit nga Zyra
Kombëtare e Auditimit për vitin 2023

Nr. Komponenta e auditimit (kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e ndërmarrura dhe rezultatet konkrete në lidhje me zbatimin e rekomandimit	Statusi i rekomandimit (i zbatuar, pjesërisht i zbatuar ose i pa zbatuar)	Sfida e hasura në zbatimin e rekomandimit
1. 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit	Rregulla financiare nr. 01/2013/MF "Mbi shpenzimin e parash publike", neni 18 pikë 3 specifikon se shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Rrjedhimisht, neni 11 i UA 19/2009 për planin kontabël, kërkon nga ZKA dhe ZKF që të sigurojnë që të gjitha transaksionet janë regjistruar në SIMFK sipas strukturës së planit kontabël dhe klasifikimeve të përcaktuara me këtë UA. Nga auditimi i pagesave, si dhe shpalosjet në raportin vjetor financiar, si rezultat i vendimeve gjyqësore, nga Thesari janë realizuar pagesa në vlerë 921,959€.	Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo të ridentinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme), që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.	Gjatë vitit 2023 Komuna e Gjakovës ka ndërmarrë të gjitha masat për të mënjанuar Çështjen B1 mirepo nuk janë pranuar nga niveli qendrorë.	Pjesërisht i zbatuar	

		investimeve kapitale janë paguar 790,206€ për shpenzimet që i takojnë kategorisë së pagave dhe mëdijëve/shujtave, si dhe për mallra dhe shërbime në shumë prej 54,567€; dhe • Nga kategoria mallrave dhe shërbimeve janë paguar 77,187€ për shpenzimet që i takojnë kategorisë së pagave dhe mëdijëve/shujtave. Duhet cekur se Komuna e Gjakovës kishte bërë kërkesë në Ministrinë e Financave Punës dhe Transfereve (MFPT) që ti mundësohet transferi i mjeteve nga kategoria e investimeve kapitale në kategorinë e pagave, dhe nga ministria është kërkuar që kjo kërkesë të aprovohet në kuvendin komunal. Edhe për kundër faktit se komuna e kishte marrë aprovimin nga kuvendi komunal, ministria në shpresën pasuese nuk kishte lejuar transferin e mjeteve sipas kërkesës së komunës. Pagesat për paga jubilare dhe shujta kanë ndodhur si rezultat i kontratës kolektive shpenzimet e të cilave nuk janë planifikuar në buxhet dhe keq klasifikimi ka ndodhur si rezultat i regjistrimit			
--	--	---	--	--	--

Zyra e Kryetarit të Komunës

		të shpenzimeve jo sipas kategorive ekonomike përkatëse.			
2.	2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmerisë	Rregulloria 2022 për taksa komunale për leje ndërtimi dhe leje rrërimi, neni 17, paragrafi 2 përcakton se; për lejet e ndërtimi për punët ndërtimore që matën me metër katrore (m2) për kategorinë II, ku tarifa për metër katror është 1.71€. Gjatë auditimit të mostës/lëndës e cila ka të bëjë me të hyrat nga lejet e ndërtimit, kemi vërejtur se komuna në një rast nuk kishte aplikuar si duhet këtë taksë. Komuna kishte ngarkuar aplikuesin në shumën 43,502€, derisa duhej të ngarkonte të njëjtin për shumën prej 27,449€. Dobësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm kanë rezultuar me gabim në aplikimin e drejtë të tarifës administrative siç e parashihet rregulloria.	Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë se kontrollat brenda drejtorive janë efektive në mënyrë që tarifat e përcaktuara të aplikohen drejtë dhe saktë në mënyrë që mos të dëmtohen pranusit e këtyre shërbimeve.	Pas evidentimit të gabimit teknik, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtje të Mjedisit në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa kanë ndërmarrë të gjitha veprimet për të kthyer mjetet tek pala.	Zbatuar
3.	Çështja A2 - Mangësi në pagesa për projektin kapital	Bazuar në paragrafin 2 të nenit 24 të kontratës "Zgjerimi i rrugës Martirët e Kombit/Hytja Perëndimore e Qytetit" mes Komunës së Gjakovës dhe OE ku specifikohet se; "Autoriteti kontraktues duhet të paguaj kontraktuesit shumën e certifikuar nga menaxheri i	Rekomandimi A2 Kryetari duhet të shtoj masat e kontrollit në menaxhimin e kontratave dhe të siguroj se menaxherët e	Pas analizimit të këtij rasti, kjo e gjetur është gabim teknik, përderisa punët për vlerën e cekur janë të ekzekutuara. Ky artikull ka qenë në paramas por nuk	Zbatuar

		projektit brenda 30 ditëve nga data e çdo certifikate". Gjatë testimit kemi vërejtur se në tri (3) mostra/ pagesave të cilat lidhen me projektin "Zgjerimi i rrugës Marturët e Kombit/Hyrtja Perëndimore e Qytetit, ishin paguar shuma prej 6,077€ më shumë sesa ishin realizuar punët për këtë projekt, edhe pse ende nuk janë kryer të gjitha situacionet për këtë projekt. Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve të brendshme dhe mbikëqyrjes së dobët nga menaxherët e kontratave gjatë realizimit të projektit kapitale.	kontratave dhe mbikëqyrësit e tyre të mos aprovojnë situacione të punëve të pa përfunduara në të kundërtën të rishikojnë pagesat e çdo situacioni me qëllim të barazimit para ekzekutimit të pagesës së fundit.	kanë qenë të llogaritura në total të vlerës së kontratës, pasi që formula e llogaritjes se rekapitullimit nuk e ka përfshirë edhe këtë artikull. Menaxherët e Kontratës rishikojnë pagesat e çdo situacioni me qëllim të barazimit para ekzekutimit të pagesës së fundit. Do të shtohen kontrollet e brendshme sipas nevojës.		
4.	Çështja A3 - Vonesa në përfundimin e punëve të kontraktuara	Rregulla nr. 01/2022 për prokurim publik taksativisht në neni 70.23 pika b parashihet se menaxheri i kontratës duhet të sigurojë se operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë. Në kontratat publike të nënshkruara mes komunës dhe kontraktuesëve, përcaktohen kushtet e veçanta kontraktuale si dhe afati kohor për realizimin e projektit. Menaxherët e	Rekomandimi A3 Kryetari duhet të sigurojë vendosjen e kontrolleve në këtë fushë me një mbikëqyrje rigoroze në menaxhimin e kontratave. Realizimi i kontratave të bëhet në përputhje	Kryetari i Komunës në muajin Mars 2024 ka themeluar Sektorin për Menaxhimin e Kontratave dhe Zhvillimin e Projekteve si mekanizëm për organizimin e mirëfillt të	Zbatuar	Sektori është në proces të vazhdueshëm të konsolidimit dhe plotësimit me kapacitetet të nevojshme njëtrëzore, dhe se ka sfida në realizimin e

		kontratave duhet të monitorojnë dhe të sigurojnë se kontratat po realizohen si duhet dhe në afatin e përcaktuar. Në dy (2) raste, kemi evidentuar vonesa në realizimin e projekteve, si në vijim: • Kontrata "Ndërtimi i terreneve të tenisit" në vlerë 241,552€, e nënshkruar më datë 01.09.2023, nuk është kryer sipas planit dinamik prej 90 ditë që rezulton në vonesë rreth 2 muaj. • Kontrata "Zgjerimi i rrugës Martirët e Kombit-Hyrja Perëndimore e Qytetit" në vlerë 1,004,545€, e nënshkruar më datë 03.08.2023, nuk është kryer sipas planit dinamik prej 120 ditë që rezulton në vonesë rreth 3 muaj. Deri sa ishim nën auditim (prill 2024), këto dy projekte ende nuk ishin finalizuar. Shkak i vonesave ishte dinamika jo adekuate e operatorëve për të përmbyllur projektin.	me planin dinamik/afatin për kryerjen e punëve/furnizimeve dhe për vonesat e pa arsyetuara, të aplikohen masat/ndëshkime t e parapara në kontratë.	Menaxherëve të Kontratave. Përmes komunikimit me shkrim dhe takimeve të përbashkëta mes Udhëheqësit të Sektorit dhe Menaxherëve të Kontratave, është kërkuar që të intensifikohen mbikëqyrja e realizimit të kontratave të cilat ata menaxhojnë.		plotë të funksionit të tij.
5.	Çështja B2 - Dobësi në procesin e veprimta	Sipas Ligji nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajshme, nenit 15.2 përcakton se; veprimtaritë inspektouese kryhen çdo vit për të paktën njëzetë përqind (20%) të të gjitha	Rekomandimi B2 Kryetari të sigurojë përmirësimin e procesit të organizimit të	Sektor i Pronës pranë drejtorisë për Buxhet dhe Financa ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për arritjen e % se	Pjesërisht i zbatuar	* Numri total i pronave të evidentuara nga Auditorët është gabim. Në bazë të korrespondenc

rive inspektu ese të pronave	objekteve brenda territorit të Komunës. Komuna për vitin 2023 nuk ka arrit të kryej inspektimin e 20% të pronave të regjistruara, ku prej 38,209 të pronave, gjatë vitit 2023 ka inspektuar vetëm 4874 prej tyre, apo 13% të tyre. Kjo ka ndodhur si rezultat i menaxhimit jo efikas të veprimtarive inspektuese dhe numrit të pamjaftueshëm të stafit.	veprimtarive inspektuese sipas kritereve ligjore të përcaktuara në mënyrë që ndryshimet eventuale nga inspektimet të jenë regjistruar, ashtu që shënimet rreth tatimit në pronë të jenë të plotë.	prona të inspektuara të paracaktuara me Ligji nr. 06/L-005		ës përmes emailit mes Udhëheqësit të Sektorit të Tatimit në Pronë dhe Auditorëve është konfirmuar numri total i pronave prej 33,239
6. Çështja B3 - Dobësi në përgatitjen e specifikave	Ligji i prokurimit publik 04/L-042, neni 28, paragrafi 2 përcakton se: "Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e	Rekomandimi B3 Kryetari duhet të sigurojë se funksionon kontrolli i duhur përmes zyrës së	Sektori i prokurimit siguron funksionon kontrolli të duhur, ashtu që, të rishikoj nëse njësitë e kërkuese bëjnë	Zbatuar	Vlen të theksohet se Sistemi i Tatimit në Pronë ka qenë jashtë funksionit në gjysmën e parë të janarit 2024 dhe dhjetorin e plotë të vitit 2024.

cionit teknik në dosient e tenderëve	prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifiktë teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik”. Në dy raste të testimit të procedurave të prokurimit (për projektet: Rehabilitimi i rrugëve me asfalt dhe Zgjerimi i rrugës martirët e kombit hyrja perendimore) kemi vërejtur se autoriteti kontraktues si në njoftimin për kontratë, ashtu edhe në dosjen e tenderit, të cilat lidhen me projekte infrastrukturë, kishite kërkuar nga ofertuesit të kenë një auditor udhëheqës (lead auditor) të licencuar nga autoritetet kompetente. Kjo kishite ndodhur për faktin se njësisia kërkuese kishite vendosur një kërkesë të tillë gjatë përpilimit të kërkesës për projektet në fjalë dhe zyra e prokurimit nuk kishite argument për ta larguar nga	prokurimit, ashtu që, të rishikoj se njësitë kërkuese bëjnë hartimin e specifiktive teknike sipas kërkesave ligjore dhe nevojave të komunës duke përcaktuar standardin e cilësisë së punës apo furnizimit.	hartimin e specifiktiveve teknike sipas kërkesave ligjore dhe nevojave të komunës duke përcaktuar standardin e cilësisë së punës apo furnizimit.		
--------------------------------------	--	--	--	--	--

		dosja e tenderit sepse nuk ishte kompetente.			
7.	Çështja B4 - Vonesa në pagesën e faturave	Liçji nr. 03 /L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 39.1 përcakton që secila faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë të mallrave dhe shërbimeve të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike pas marrjes së faturës. Ndërsa, sipas nenit 40, fatura mund të ekzekutohet direkt nga Thesari pas marrjes së urdhërit të prerë nga gjykata/ përmbaruesi.	Rekomandimi B4 Kryetari duhet të siguroj se hyrja në obligime bëhet vetëm pasi mjetet buxhetore të jenë zotuar paraprakisht, si dhe obligimet financiare ndaj kontraktuesve të paguhen brenda 30 ditëve nga data e pranimit të faturave në mënyrë që të shmangen pagesat shtesë të interesit nga vendimet gjyqësore/ përmba rimore.	Kryetari i Komunës ka kërkuar nga Drejtorët e Njësive, Menaxherët e Kontratave dhe Sektorit të Financave që të respektohet me përpliqëri neni 39.1 të Liçjit nr. 03 /L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë	* Vonesat e shkaktuara me rastin e ndarjes së Drejtorisë së Shërbimeve Publike në dy Drejtori. Pagesa e borxheve është kryer me buxhet suplementar në mënyrë të rregullt dhe nuk ka të bëjë me vendime gjyqësore as me shpenzime të interesit por është pagesë e rregullt.

	procedura përbarimore/ gjyqësore për inkasimin e mjeteve. Megjithatë, nga analiza e raportit të shpenzimeve kemi vërejtur se komuna ka paguar borxhin kryesor 160,832€ dhe shpenzimet e interesit 12,622€ si rezultat i mosprocedimit të pagesave brenda afatit të përcaktuar ligjor. Shkak i mos pagesës me kohë të detyrimeve është mungesa e mjeteve buxhetore për pagesën me kohë e faturave nga drejtoritë përkatëse.			
8. Çështja B5 - Mangësi në procedimin e pagesave	Rregulla financiare nr.01/2013, neni 22 përcakton që; fillimisht duhet të bëhet kërkesa për blerje, më pas zotimi i mjeteve, të procedohet urdhërblerja, pastaj të pranohet malli apo shërbimi, dhe pas pranimit të faturës të ekzekutohet pagesa. Gjatë testimit të kategorisë mallra dhe shërbime në dy raste, faturat në vlerë 33,895€, zotimi i mjeteve ishte bërë pas pranimit të mallit apo shërbimit/ punëve dhe pranimit të faturës.	Rekomandimi B5 Kryetari duhet të sigurojë se respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi sa i përket realizimit të pagesave, në mënyrë që gjatë procedimit të pagesave, të bëhet fillimisht zotimi i mjeteve, pastaj të nxirret urdhër blera dhe në fund	Kryetari i Komunës përmes emailit dhe takimeve të drejtpërdrejta ka kërkuar nga të gjitha njësit kërkesues, Sektorit për Menaxhimin dhe Zhvillimin e Projekteve, Sektorit të Prokurimit, dhe Zyrtarit Kryesor Financiar që të respektojnë hapat e përcaktuar me Rregulla financiare nr.01/2013 sa i	Zbatuar

		Kjo ka ndodhur për faktin që nuk janë zbatuar rregullat për shpenzimin e parashë publike nga ana e zyrtarëve përgjegjës, si dhe nga mos planifikim i duhur i trijdhës se parashë.	të pranohet malli/ shërbimi dhe të kryhet pagesa.	përket realizimit të pagesave.		
9.	Çështja B6 - Dobësi në menaxhin e projekteve përmes platformës elektronike të e-prokuri mit	Rregullorja nr. 001/2022, për prokurimin publik, neni 70, pika 2, Vlerësimi i performancës së kontraktuesve do të bëhet: i) në sistemin të prokurimit elektronik nëpërmjet modulit për vlerësim të performancës së kontraktuesve; ii) nga menaxherët e kontratës dhe mbikqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, dhe iii) në pajtim me manualin për përdorimin të modulit për vlerësim të performancës së kontraktuesve.	Rekomandimi B6 Kryetari duhet të sigurojë ndjekjen e trajnimeve për menaxherët e projekteve, për tu siguruar që menaxhimin i kontratave do të mbahet dhe arkivohet nga sistemi i prokurimit publik.	Kryetari i Komunës në muajin Mars 2024 ka themeluar Sektorin për Menaxhimin e Kontratave dhe Zhvillimin e Projekteve si mekanizëm për organizimin e mirëfilltë të Menaxherëve të Kontratave.	Zbatuar Ky sektor tanimë ka filluar implementimin e sistemit të e-prokurimit si platforma e vetme për menaxhimin dhe arkivimin e kontratave, ku në bazë të statistikave tona moduli për menaxhimin e kontratave përdoret	

	prokurim ka ndodhur për mungesë të informatave/njohuri të duhura nga menaxherët e kontratave rreth aplikimit të modulit për menaxhimin e kontratës në eprokurim.	për 83.01 % të kontratave. Do të vazhdohet me trajnime të vazhdueshme për menaxherët e rinj të kontratave				
10.	2.3 Çështjet tjera të menaxhi mit financiar dhe të pajtuesh mërisë Çështja B7 – Rritja e llogarive të Pronën e Paluajtshme. Ligji i lartë	Ligji nr. 08/L-176 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që Përbëjnë Procedura të Veçanta Administrative dhe Harmonizimin e tyre me Ligjin nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka hyrë në fuqi më dt. 21.07.2023 dhe ka për qëllim harmonizimin e procedurave të veçanta administrative me procedurën e përgjithshme administrative, i cili ka plotësuar dhe ndryshuar disa ligje dhe një ndër to edhe Ligjin nr. 06/L-005 për Tatimin në	Rekomandimi B7 Kryetari duhet të analizoj efektivitetin e mekanizmave në dispozicion për mbledhjen e të arkëtueshmeve, duke përfshirë edhe veprimet ligjore shtesë përmes përmbaruesve, për të siguruar	N/A Komuna e Gjakovës ka iniciuar raste që përmes përmbarimit të bëj mbledhjen e të arkëtueshmeve, dhe se një masë të tillë do ta vazhdojë ta praktikojë.	Pjesërisht e zbatuar	

Zyra e Kryetarit të Komunës

arkëtues hme	shënuar përmes nenit 112 ka ndryshuar procedurën e ekzekutimit të vendimit mbi detyrimet tatimore të papaguara, ashtu që për ekzekutimin e këtyre vendimeve (sipas nenit 30 të Ligjit bazik) nuk do të përdoret procedura e përbarimit privat, por vetë komuna do t'i ekzekutojë duke i përdorur të njëjtat mjete që mund t'i përdor ATK për mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara. Megjithatë, procedura përbarimore mund të përdoret ndaj faturës së tatimit në pronë. Që nga hyrja në fuqi e këtij ligji nga komuna nuk duhet të iniciohet procedura e përbarimit ndaj Vendimeve të nxjerra sipas nenit 30 të Ligjit bazik. Po ashtu edhe neni 16 i Rregullorës për Taksa Tarifa, Ngarkesa dhe Shërbimet Komunale, përcakton mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara duke përdorur masat e mbledhjes së detyrueshme.	arkëtimin e plotë të tyre.	shoqërore të cilat menaxhohen nga AKP, rrijedhimisht duke kontribuar në rritjen e obligimi në baza vjetore. Në këtë rast obliguesi kryesor (mbi 3 milion euro) është AKP.
Llogaritë e arkëtueshme kanë rritje, krahasuar me vitin 2022. Në fund të vitit 2023 të			

		arkëtueshmet ishin rritur për 1,325,662€, kjo vërehet tek ndërmarrjet shoqërore (tatimi në pronë dhe taksa në firmë), ku borxhi ka vlerën prej 4,198,250€. Rritja më e madhe e të arkëtueshmeve është në tatimin në pronë, krahasuar me vitin paraprak këtë vit obligimet ndaj tatimit në pronë janë rritur në vlerë 949,465€ apo në masën prej 9%. Komuna kishte bërë përpjekje për inkasimin e mjeteve të pa arkëtuara nga tatimi në pronë, qiratë nga toka, dyqanet, tregjet apo taksat në firmë, përmes letërkujtesave si dhe vërejtjeve përfundimtare ndaj debitorëve, mirëpo këto masa nuk ishin mjaft efektive dhe trendi i rritjes së obligimeve ndaj komunës është negativ, për faktin e mosdërgimit të borxhlinjëve tek përmbaruesit. Kjo ka ndodhur për shkak të kontroleve dhe veprimeve të pambajtueshme në arkëtimin e të hyrave.				
--	--	---	--	--	--	--

Hartimi i Planit të Veprimit për Zbatimin e Rekomandimeve (PVZR) është përgatitur konform afatit të parapare sipas Zyrës Kombëtare të Auditimit. PVZR është trajtuar në mbledhjen e grupit punues me datë 27/02/2025 dhe pastaj është dërguar në Zyrën Kombëtare të Auditimit.

- Raporti i Auditimit për Komunën e Gjakovës për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2023, i publikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit, është prezantuar në seancën e rregullt të Kuvendit të Komunës së Gjakovës.

Përditësimi i të dhënave në Reportin Periodik për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Zyra Kombëtare e Auditimit është kryer nga Grupi Punues të formuar përmes Vendimit nr. 01-112/02-10677 për përgatitjen e Planit të Veprimit dhe për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2023.

Gjakovë,

Ardian Gjini,

Datë 28.02.2025

Kryetar i Komunës së Gjakovës

